

Fillimi > -Kronikë

Automatik e municion luftarak, kontrolli policor në banesë ‘fundos’ 51-vjeçarin durrsak

30 Tetor, 2020 09:43 | 589 shfletime



Madhësia e tekstit:  

- 
- Policia e Durrësit ka goditur një rast të armëmbajtjes pa leje, duke sekuestruar një armë zjarri dhe municion luftarak.
- 
- Në pranga ka rënë 51-vjeçari D. R., ndërsa gjatë kontrollit në banesë i janë gjetur 1 armë zjarri automatik, 4 krehra dhe 70 fishekë.

Njoftimi i policisë:

Forcat Operacionale në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës, në zbatim të Planit të Masave për parandalimin dhe goditjen e paligjshmërisë, kapjen e personave në kërkim dhe atyre që disponojnë armë zjarri në banesë, në bazë të informacioneve të siguruar në rrugë operative, kanë organizuar punën dhe kanë ushtruar kontroll në një banesë në lagjen nr. 16, Durrës dhe si rezultat kanë goditur një rast të armëmbajtjes pa leje.

Në vijim të veprimeve, nga specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Durrës u arrestua në flagrancë shtetasi D. R., 51 vjeç, banues në Durrës.

Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e tij, shërbimet e Policisë kanë gjetur 1 armë zjarri automatik, 4 krehra dhe 70 fishekë, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Materialet në ngarkim të shtetasit D. R. i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, për veprime të mëtejshme.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: [arme zjarri](#) [arrestim](#) [Durrës](#) [municion](#)


TË NGJASHME

Atentat me armë zjarri në Asti të Italisë, plagoset shqiptari. Shënjestër një 40-vjeçar me precedentë kriminale
26 Tetor, 2020


EMRI/ Ja kush është këngëtarja kosovare e ndaluar në Morinë, po hynte në Shqipëri me "Audi Q7"
19 Shtator, 2020

Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË



"Për 15 vite asnjë funksion në drejtësi", nis seanca për ish-gjyqtaren Arjana Fullani në KPA
04 Nëntor, 2020



Video/ Policë të maskuar ndalojnë 'Audin' në Lungomare, kapet një person me rrezikshmëri të lartë, çfarë u sekuestrua
04 Nëntor, 2020


Përkeqësohet gjendja shëndetësore e grevisteve, dy prej tyre përfundojnë në spital, gratë: Po na bëjnë presion me SMS
04 Nëntor, 2020

Makina merr flakë në ecje e sipër, dyshimet e para të policisë
04 Nëntor, 2020

Plagosje me armë zjarri në Fier, 34-vjeçari përfundon në spital me plumb në këmbë
04 Nëntor, 2020

Ishte ngarkuar me fruta-perime dhe 2.6 ton drogë, policia jep informacion për kamionin e bllokuar sot në Han të Hotit
03 Nëntor, 2020

KATEGORIA VIDEO



Video/ Policë të maskuar ndalojnë 'Audin' në Lungomare, kapet një person me rrezikshmëri të lartë, çfarë u sekuestrua
04 Nëntor, 2020

Zgjedhjet në SHBA, Frrok Çupi: Trump është modeli i fjalës së lirë
03 Nëntor, 2020

Trump apo Biden president i SHBA? Deputeti socialist: Mendoj se do ketë ndryshime
03 Nëntor, 2020

SHBA vendos sot/ Minxhozi: Shpallja e procesit të numërimit si manipulim nga Trump, e paprecedent. Rezultati do të kalojë në gjykata
03 Nëntor, 2020

Pandemia/ Basha thirrje pas takimit me mjekët: Të rritet numri i testimeve! Situata po përkeqësohet
03 Nëntor, 2020

Abuzim miliona \$ me naftën/ Skandal në Gjykatën e Apelit, biznesmeni Isuf Berberi lirohet pa u arrestuar
03 Nëntor, 2020